



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA SHQIPTARE PËR
TË DREJTAT E AUTORIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE

Nr. 288 Prot, datë 12/11/2007

Nr. 12679 Prot, datë 12/11/2007

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

ZYRËS SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT

DHE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Ky memorandum lidhet me iniciativën e

Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, e njohur me poshtë si “ZSHDA”, i përfaqësuar nga Titullari i tij, Drejtore Znj. Nikoleta GJORDENI, institucion publik, në varësi të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, i cili vepron në bazë të ligjit nr. 9380 datë 28.04.2005, “Për të drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 232 datë 19.04.2006 “Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të drejtën e Autorit”, me qëllim mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, private a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike, shkencore.

Me

Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, i njohur më poshtë si “DPD”, i përfaqësuar nga Drejtori Z. Përparim DERVISHI, institucion publik, në varësi të Ministrisë së Financave, i cili vepron në bazë dhe për zbatimin e dispozitave të Ligjit

nr.8449, date 27.1.1999 "Per Kodin Doganor te Republikes se Shqiperise", me qëllim mbikëqyrjen e veprimtarisë së shkëmbimit ndërkufitar të mallrave në Republikën e Shqipërisë.

Neni 1 **Rëndësia**

Duke qenë se:

- Fusha e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtës së autorit ka një rëndësi të veçantë në procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit;
- Angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit synojnë, ndërmjet të tjerash, garantimin e luftës kundër piraterisë së produktit intelektual si dhe respektimin e të drejtave të autorit në këtë fushë;
- Shteti shqiptar nëpërmjet institucioneve të tij, ka detyrimin për zbatimin dhe respektimin e konventave ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale, ku Republika e Shqipërisë ka aderuar;
- Gjendja mjaft e rënduar nga mos respektimi i të drejtave të autorit, të garantuara nga Neni 58 i Kushtetutës, prej subjekteve vendas apo të huaj që ushtrojnë veprimtari tregtare import – eksporti, të produktit intelektual letrar, artistik ose shkencor, brenda
- Ndalimi ose sekuestrimi i pajisjeve apo mjeteve që shërbejnë për të hedhur apo fiksuar, në mbajtëse zëri apo zëri dhe figure produktin intelektual, në mënyre pirate, përbën një nga aspektet e rëndësishme të angazhimeve të përbashkëta të dy institucioneve;
- ZSHDA është institucioni Garant i Nenit 58 të Kushtetutës, për monitorimin dhe garantimin e respektimit të të drejtave të autorëve krijues dhe autorëve interpretues apo ekzekutues.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë memorandum i cili vendos bashkëpunimin konkret institucional ndërmjet ZSHDA dhe DPD, në nivel qendror dhe lokal, shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit dhe zgjerimin e formave të bashkëpunimit në të ardhmen.

Neni 2 Baza ligjore

Ky memorandum bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në ligjet e tyre organike dhe konventat ku Republika e Shqipërisë është palë:

-Në **Konventën e Bernës**, "Për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike", nënshkruar në Bernë më 09.09.1886, plotësuar me aktin e Parisit me 24.07.1971 dhe ndryshuar me 02.10.1979.(Aderimi me dekret të Presidentit të Republikës nr.487 datë 09.03.1993).

-Në **Konventën e Romës**, "Për mbrojtjen e artistëve interpretues dhe ekzekutues, të prodhuesve të fonogrameve dhe të organizmave të radiodifuzionit", nënshkruar në Romë më 26 tetor 1961. (Aderimi me ligjin nr.8579, datë 16.02.2000 të Kuvendit të Shqipërisë).

-Në **Konventën e Gjenevës**, "Për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër riprodhimit të paautorizuar të tyre" nënshkruar në Gjenevë më 29 tetor 1971. (Aderimi me ligjin nr.8585, datë 15.03.2000, të Kuvendit të Shqipërisë).

-Në **Konventën Universale** "Për të Drejtën e Autorit" dhe Dy Protokollet Shtesë të Saj, nënshkruar në Paris, më 24 korrik 1971. (Aderimi me ligjin nr.9129, datë 08.09.2003, të Kuvendit të Shqipërisë)

-Në Marrëveshjen e **TRIPS** –it.

-Në Ligjin nr. 9380, datë 28.04.2005 "**Për të drejtën e autorit dhe te drejtat e tjera te lidhura me to**" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave **nr. 232 datë 19.04.2006**, pika 18.

-Në ligjin Nr.8449, date 27.01.1999 "**Per Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë**" dhe VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "**Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor**".

Neni 3 Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është përcaktimi i modaliteteve, instrumenteve dhe mënyrave të bashkëpunimit për implementimin sa më të përshpejtuar, të ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe te drejtat e

tjera te lidhura me to”, si dhe bashkëpunimi në të ardhmen, në nivel lokal me Drejtoritë Rajonale Doganore dhe ZRDA (Zyrat Rajonale të së Drejtës së Autorit në nivel qarku), për të monitoruar e garantuar respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të, në luftën kundër fallsifikimit dhe piraterisë së pronësisë të produktit intelektual në fushën e artit, kulturës dhe shkencës.

Neni 4

Forma e Bashkëpunimit

Palët bien dakord si më poshtë:

a. Institucionalizohet, sipas këtij memorandumi, bashkëpunimi reciprok, në përmbushje të detyrimeve ligjore të ndërsjella, në sferën e forcimit të luftës kundër piraterisë, fallsifikimit dhe respektimit të të drejtave të autorit, duke konsideruar prioritet, me një rëndësi shumë të madhe për interesat kombëtare, zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të saktësuara në angazhimet e marra në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

b. Palët, ZSHDA dhe DPD, bashkëpunojnë me njëra – tjetrën për hartimin e planeve të përbashkëta të veprimit, në funksion të luftës kundër piraterisë, kontrabandës dhe çdo veprimi tjetër që ka për qëllim cënimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të.

c. ZSHDA jep informacion periodik mbi listën e subjekteve të regjistruar pranë kësaj zyre, si titullmbajtës të ligjshëm për importimin/eksportimin e mallrave të përcaktuara në paragrafin e mësipërm të këtij neni.

d. DPD gjatë kryerjes së detyrave funksionale, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin Doganor dhe Dispozitat Zbatuese të tij në lidhje me ndalimin e vënies në qarkullim të lirë, eksportimit, rieksportimit, dhe vendosjes në një regjim të caktuar pezullues mallrat e njohura si pirate, nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentave të paraqitur apo nuk mund të arrijë në një përfundim, atëherë i kërkon ZSHDA informacion apo ekspertizë, sipas rasteve specifike.

e. ZSHDA dhe DPD do të shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, rast pas rasti e sipas specifikës, në masën që lejojnë ligjet ku bazohet ky memorandum, duke respektuar në rast nevojë, karakterin e tyre konfidencial, dhe që kanë të bëjnë me problemet e luftës kundër piraterisë, fallsifikimit si dhe respektimit të të drejtave të autorit.

Neni 5
Pika e kontaktit


Secila prej palëve do të autorizojë një ose disa përfaqësues, për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, duke përshpejtuar kohën administrative, sipas formave që përcaktohen nga ky memorandum.

Neni 6
Nënshkrimi dhe Hyrja në fuqi

Ky memorandum nënshkruhet sot më dt. 12.11.2007, në dy kopje origjinale, për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

**ZYRA SHQIPTARE PËR
TË DREJTËN E AUTORIT**

Znj. Nikoleta GJORDENI



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE**

Z. Përparim DËRVISHI

